

VENDIM
Nr. 117, datë 22.7.2019

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË “MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OSHEE SHA DHE FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 24, DATË 15.2.2017, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 58, DATË 15.4.2019

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, nenin 19, pika 2 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha, dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore “Mbi miratimin e ndryshimit të marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019”,

konstatoi se:

- ERE me vendimin e bordit nr. 24, datë 15.2.2017 ka miratuar “Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e bordit nr. 58, datë 15.4.2019.

- ERE në vendimin e bordit nr. 91, datë 31.5.2019 “Mbi një ndryshim në “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019”, ka vendosur: Fillimin e procedurës për ndryshimin e nenit 20, pika 1 të “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.

- ERE me shkresën e saj nr. 402 prot, datë 13.6.2019 ka njoftuar vendimin nr. 91, datë 31.5.2019, subjekteve si: OSHEE sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, Shoqatës “FIAA”, si dhe “Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike” (AAES) duke kërkuar nga ata opinione dhe sugjerime lidhur me ndryshimin e kësaj marrëveshje, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

- ERE në shkresën me nr. 32/30 prot, datë 6.6.2019, ka bërë njoftimin në median e shkruar, lidhur me vendimin nr. 91, datë 31.5.2019.

- Autoriteti i Konkurrencës, në shkresën e tij me nr. 380/2 prot, datë 2.7.2019 protokolluar në ERE me nr. 402/1 prot., datë 3.7.2019 shprehet se: Autoriteti i Konkurrencës mbasi shqyrtoi marrëveshjen e miratuar me vendimin e ERE-s nr. 91, datë 31.5.2019 konstaton se marrëveshja nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- Duke qenë se marrëveshjet me furnizuesit, lidhen konform “Marrëveshjes TIP”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, dhe po ashtu asnjë nga palët e vëna në dijeni nuk kanë shprehur kundërshti mbi ndryshimet e propozuara, me procedurën e nisur me vendimin nr. 91, datë 31.5.2019 të bordit të ERE-s, gjykohet i arsyeshëm amendimi i “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet

OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, duke ndryshuar nenin 20, pika 1 (ekzekutimi nga palët) të saj.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 20, pika 1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019 si më poshtë:

- Neni 20.1 ndryshon, “Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën palë dhe 1 dërgohet në ERE për dijeni”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti